



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR  
REKTORATI

Nr. 1373 prot.

Gjirokastrë, më 18 09 . 2024

**Lënda:** Hapet thirrja për pjesëmarrje në Programin Erasmus+ me partneritetin CARTES, Spanjë

Në kuadër të Programit Erasmus+, CARTES hap thirrjen për shkëmbim studentësh me Universitetin e Gjirokastrës.

Sipas Marrëveshjes Ndërinstitucionale, Universiteti i Gjirokastrës do të marrë pjesë me 10 (dhjetë) studentë, 5 (pesë) prej të cilëve për mësimnxënie dhe 5 (pesë) për praktikë mësimore, për një periudhë tre-mujore. Thirrja është e hapur për studentët e ciklit të parë të studimit (Bachelor), ciklit të dytë (Master) dhe programeve dy-vjeçare në Fakultetin Ekonomik. Gjuha e përdorur do të jetë anglisht B2 ose spanjisht B2.

Të interesuarit të dërgojnë pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor, brenda datës **27.09.2024**, në formë fizike dhe elektronike:

- vërtetim studenti;
- listë notash;
- letër Interesi në anglisht;
- CV të detajuar mundësisht në formatin EUROPASS në anglisht;
- provë / certifikatë të njohurive të gjuhës angleze ose spanjolle në nivelin B2;
- fotokopje të pasaportës dhe kartës së identitetit.

Dokumentacioni juaj do të vlerësohet paraprakisht nga një komision AD HOC i ngritur pranë UGJ-së dhe më pas, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor do t'i përcjellë nominimet te CARTES për vlerësimin përfundimtar të aplikantëve të cilët do të përzgjidhen.

Zv/Rektore për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor

Prof. asoc. Merita Isara

